

Gjykata Themelore Ferizaj-Dega Kaçanik, Divizioni per Kundervajtje ,dhe ate gjyqtarja Zajrete Muhaxheri me procesmbajtesen Indira Beqa , punetore e kesaj gjykate ,në lenden kundërvajtëse kundër të pandehurit Habib Guri nga fsh.Nikaj, komuna e Kaçanikut , për shkak të kundërvajtjes nga neni 8 par 1 I sanksionuar me nenin 17 par 1.nenpar.1.1 te Ligjit per deklarimin ,prejardhjen dhe kontrollin e pasurise se zyrtareve te larte publik dhe deklarimin,prejardhjen dhe kontrollin e dhuratave per te gjithë personat zyrtare ,e në baze të nenit 31,73,74,199 dhe nenit 9 të Ligjit për Kundërvajtje me dt. 19.11.2013 merr këtë;

AKT V E N D I M

I pandehuri Habib Faik Guri ,I lindur me dt.09.12.1965 ne fsh.Nikaj ,komuna e Kaçanikut ,ku edhe e ka vendbanimin , shqiptar, shtetas i Republikës se Kosoves,I martuar prind i 5 femijeve ,ka te kryer fakultetin e elektroteknikes , keshilltar komunal ne Asamblene komunale ne Kaçanik ,I gjendjes së mesme ekonomike,

Ë sht ë për gj e gj ë s

REPUBLICA E KOSOVES REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVO	
AGJENCIA KUNDER KORRUPSIONIT AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep.	Nr Prot.
Dep. <u>DPK/DMP</u>	Br Prot. <u>03-4083/13</u>
Dep.	Prot No.
Nr. I faq.	Data
Broj stranica <u>03</u>	Datum <u>27.11.2013</u>
Nr. pages	Date

Sepse si zyrtar I larte publik ne poziten e keshilltarit komunal ne Asamblene Komunale ne Kaçanik ,nuk e ka bere deklarimin e rregullit vjetor te pasurise prane Agjensise Kunder Korrupsionit deri me daten 31.03.2012.

Me qka ka kryer kundervajtje nga neni 8 par 1 I sanksionuar me nenin 17 par 1 nenpar.1.1 Ligjit per deklarimin ,prejardhjen dhe kontrollin e pasurise se zyrtareve te larte publik dhe deklarimin,prejardhjen dhe kontrollin e dhuratave per te gjithë personat zyrtare

Andaj në bazë të nenit 31,73,74 dhe 199 te Ligjit per Kundervajtje dhe nenit 17 par 1 nenpar.1 te Ligjit per deklarimin ,prejardhjen dhe kontrollin e pasurise se zyrtareve te larte publik dhe deklarimin,prejardhjen dhe kontrollin e dhuratave per te gjithë personat zyrtare,

D E N O H E T

Me denim me gjobe në shumë prej 200 € (dyqind euro) ,te cilin eshte e obliguar qe ta paguaj në afat prej 15(pesëmbëdhjete) ditësh nga dita e plotfuqishmërise të këtij aktvendimi,në të kundërtën ,konform nenit 5 al.1 të Ligjit per kundërvajtje,dënimi me gjobë do t'i zevendesohet me denim me burg ashtu qe per qdo dite burgu do t'i llogariten nga 15 (Njëzet) €

Detyrohet i pandehuri që në emër të shpenzimeve procedurale të paguaje pranë kësaj gjykate shumë prej prej 5.00 € ne emer te paushallit gjyqesor në afat prej 15 ditësh nga dita e plotëfuqishmërise së këtij aktvendimi nën kërcënimin e përmbarimit me dhunë.

